



Municipality of Phoenice

Pyjet dhe kullotat, nje burim mireqenie per komunitetin

Bashkise Finiq me Vendim te Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 8.6.2016 i jane transferuar ne pronesi 12.117 ha kullota, prej te cilave 8.171 ha jane kullota dimerore, 2923 ha kullota verore dhe 1.017 ha kullota vjetore. Kapaciteti ushqyes i tyre eshte per 21.624 krere dele, per 4.440 krere dhi dhe per 201 te trasha (njethundrak) qe perdoren kryesisht per transportin e qumeshtit. Transferimi u be se bashku me infrastrukturen mbeshtetese te tyre sic jane rruget e veprat e ujit etj.

Bashkise i kaluan ne pronesi edhe 9.309 ha pyje nga 16.240 ha qe ka rrethi i Sarandes, pra 57.3% te siperfaqes.

Ne territorin e bashkise mbareshtohen mbi 26.500 krere te leshta, 11.300 krere te dhirta, rreth 2000 krere lope qe kullosin ne gjendje te lire si dhe mbi 6.000 koshere bletesh.

Nje pasuri e madhe brenda fondit pyjor e kullosor jane edhe bimet medicinale, aromatike dhe tanifere. Kemi mbi 200 lloje me bime te tilla. Sherbela ka nje shtrirje te gjere dhe prodhimi i saj vjetor arrin ne disa qindra ton. Dafina po keshtu shtrihet ne mjaft zona ku mund te sigurohen me dhjetra kv gjethe dafine. Jane me dhjetra ton prodhimi vjetor i rigonit, i hithres, i cajit te malit dhe mbi te gjitha prodhimi i valanidhit qe arrin ne disa qindra ton me perdorim ne industri per prodhimin e tanines me kerkesa te vazhdushme per eksport. Nga pyjet sigurohet dhe nje sasi e mire geshtenjash kryesisht ne zonen pyjore te Dhrovjanit dhe te Leshnices.

Treguesit e mesiperme flasin se kemi te bejme me nje pasuri te madhe natyrore, qe me nje administrim dhe menaxhim te mire te saj, mund te shtohen ndjeshem te ardhurat dhe te permiresohet mireqenia e komunitetit.

Eshte nje sektor qe duhet investuar me perparesi nga bashkia dhe nxitur sektori privat me forma te larmishme per investime.

Ne kete shtrirje te gjere qe ka bashkia Finiq, me fushe, kodra e masive malore, fondi pyjor eshte dhe nje mundesi e mire per zhvillimin e agroturizmit. Baseni ujembledhes i lumit te Bistrices dhe brenda tij Syri i kalter prej 180 ha, i shpallur monument natyre por edhe perfshirja ne listen e monumenteve natyrore "Rruga e gjarprit", Ujevara e Kardhikaqit, Bokerimat e Peces (Muzine), rrapi i Muzines, Valanidhet e Dhrovjanit, rrapi i Dhivrit, etj me VKM nr. 676 date 20.12.2002 "Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare", duhen promovuar, te behen te njohura dhe te shikohet mundesia e shfrytezimit te tyre per qellime turistike.